



REPUBLIKA E SHqipërisë  
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

## FTESË PËR OFERTË

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, në mbështetje të VKM nr. 101, datë 09.02.2022, “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë e zhvillimin rural, për vitin 2022”, si dhe në zbatim të VKM nr. 1195, datë 05.08.2008, “Për blerjen, zhvillimin, prodhimin e bashkëprodhimin e programeve a të reklamave për transmetim nga operatorët radioteleviziv ose botim në median e shkruar dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore”, Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural dërgon ftesën për ofertë organeve të medias/agjencive të specializuara me këtë përmbajtje:

- 1. Objekti i programit/spotit/reklamës:** Informimi mediatic i publikut lidhur me masat e mbështetjes së programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, për vitin 2022
- 2. Nevoja për kryerjen e reklamave:** Me anë të kësaj fushate komunikimi do të bëhet i mundur realizimi i objektivit: “Për aktivitetet informuese për publikun lidhur me masat e mbështetjes nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2022”.
- 3. TV – 1 (një) Spot i përgjithshëm për Skemën Kombëtare 2022,** ku të jenë të cilësuarat masat me aplikim online që kryhen nga vetë aplikanti nëpërmjet portalit e-Albania dhe masat me dorëzim dosje aplikimi në AZHBR qendër, jo më shumë se 1 minutë.  
Spoti do të transmetohet në TV Kombëtare, gjatë periudhës së thirrjes, nga data 03.03.2022 - 17.03.2022 (shpeshësia jo më pak se 4 herë në ditë, ku shikueshmëria është më e lartë).
- 4. 13 - Video Graphic**  
Prodhimi i 13 Videove (motion graphic) 1 video për secilën masë, për përdorim në rrjete sociale, me gjatësi jo më pak se 30 sekonda, me sfond muzikor dhe voiceover (nese kërkohej), të përmbajë imazhe grafike shpjeguese sipas nevojës.
- 5. Fletëpalosje,** katër faqe, 5.000 copë
  - a. 4 ngjyra
  - b. Letër 115 gr
- 6. Printim posterash,** 1 faqe, 50 copë
  - a. 4 ngjyra
  - b. Letër 115 gr
  - c. Format A3

- 7. Poster** (banner) grafik për kryefaqen e web-it zyrtar AZHBR
  - a. Dizajn me ngjyra
  - b. Logo e AZHBR, MBZHR, E-Albania
  - c. Përmasa sipas parametrave të dritares në faqen zyrtare AZHBR
- 8. Printim Roll up**, 6 copë
  - a. Përmasat 80 x 200 cm
  - b. Material banner + mekanizëm përkatës
  - c. Roll up do të përmbajë 1 dizajn.
- 9. Reklamim «radio»**
  - a. Prodhim i 1 spoti radiofonik
  - b. Transmetimi i spotit radiofonik ne minimumi 1 radio kombëtare dhe 3 radio lokale (duke mbuluar të gjithë territorin e vendit dhe të vihet theksi që të informohen sa më shumë zonat rurale në vend)
  - c. Frekuenca jo më pak se 4 herë në ditë.
- 10. Reklamim në rrjetin social (facebook)** audienca e synuar është 100.000 përdorues në ditë, dhe frekuenca e shfaqjes të jetë 2 herë në ditë.
- 11. Publikimi i skemave mbështetëse** për vitin 2022, në median e shkruar minimumi 4 gazeta të përditshme.
- 12. Organizimi i 12 takimeve informuese** me fermerë për aplikime në skemën mbështetëse kombëtare 2022, Do të organizohen në total 12 (dymbëdhjetë) aktivitete në qarqet: Tiranë, Shkodër, Lezhë, Durrës, Fier, Berat, Vlorë, Elbasan, Korçë, Tepelenë, Gjirokastrë dhe Kukës.

Afati i fundit për paraqitjen e ofertave për përlllogaritjen e fondit limit, sipas përcaktimeve dhe kërkesave të mësipërme është data 16.02.2022, ora 16:30 pranë Zyrës Qendrore të AZHBR.

Ofertat të paraqiten në zyrën e protokollit të mbyllura në zarf, me adresë Rruga “Muhamed Gjollësja”, nr. 56, Tirane.

Falemnderit për bashkëpunimin!